



Datë: 04.06.2025

Numër Protokolli: 4000/2025

A.nr.590/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.590/2025, të datës 03.04.2025, të parashtruar nga ankuesi S.N., kundër organit të punësimit/Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike “*kompensim matrial*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.06.2025, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.590/2025, e datës 03.04.2025, e parashtruar nga ankuesi S.N.
- II. Pala ankuese udhëzohet mbi të drejtën e inicimit të kontestit civil pranë gjykatës së rregullt.

## A r s y e t i m

Ankuesi, S.N.(*në tekstin e mëtejme referuar* Ankuesi), më datë 03.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos pagesës së mjetëve materiale- pagës sipas Aktit të Emërimit Nr. 02/016-136615/24 të datës 31.12.2024 gjegjësisht nga data 01.01.2025 deri në vendimin për shfuqizim të Akt emërimit të lartpërmendur sipas Vendimit me numër protokolli 02-016-18628/25 të datës 07.03.2025, të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, përmes së cilit është anuluar konkursi me Nr. Reference: RN00015030, për pozitën Zyrtar për Gjendje Civile 1 respektivisht është zbatuar Vendimi i KPMSHCK-së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilani, ndërsa, ky i fundit, më datë 28.04.2025 ka përcjellë shkresat referuar çështjes në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave** (*në tekstin e mëtejme referuar*: Kolegji i Këshillit), vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritori administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2209/2025, të datës 03.04.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 02-016-18628/25 të datës 07.03.2025 të Kryetarit të Komunës së Gjilanit; Akt Emërimit me Nr. 02-016-136615/24 të datës 31.12.2024 në emër të ankuesit; Procesverbalin e datës 11/02/2025; Vertetimin e datës 01.04.2025; Certifikata e datës 29.01.2025; Certifikata e datës 23-24-25.01.2025; Formulari i Regjistrimit të Ankeses i datës 03.04.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesen për Përgjigje në Ankesë e datës 18.04.2025; Përgjigjen e ankesës së datës 03.04.2025; Ankesë e datës

03.04.2025;Lista përfundimtare e Vlersimit të Kandidatëve;Akt Emërimi i datës 31.12.2024;Vendimi i datës 20.02.2025;Vendimi nga Zyra e Kryetarit të Gjilanit i datës 07.03.2025; Vërtetimin e datës 01.04.2025;Vendimi i datës 14.05.2025;Vendimin e datës 31.01.2025;Vendimi i datës 29.01.2025;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka konstatuar se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton:

-Komuna e Gjilanit, më datë 06.09.2024, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00015030, Grupi i administrimit të përgjithshëm, pozita Zyrtar për gjendjen civile 1, (3) vende pune, më afat të aplikimit 07.09.2024 - 06.10.2024.

-Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, pas përfundimit të procedurës së pranimit, më datë 22.11.2024, ka publikuar Njoftimin me numër protokolli 02-016-125867/24, lidhur me shpalljen e kandidatit fitues, ashtu që sipas këtij njoftimi si kandidatë fitues për pozitën përkatëse janë shpallur F.B-I. më 92 pikë, S.N. me 89 pikë, dhe Gj.Z-R. me 76 pikë, ndërsa më datë 31.12.2024, ka lëshuar aktet e emërimit për kandidatet fitues.

Kundër aktit përfundimtar lidhur me procedurën me numër të referencës RN00015030, kandidatja A.Sh-H., kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa, Këshilli me Vendimin A.nr.2110/2024, të datës 20.02.2025, ka aprovuar ankesën e ankueses duke e anuluar në tërësi konkursin me numër të referencës RN00015030, grupi i administrimit të përgjithshëm, pozita Zyrtar i gjendjes Civile, mbi bazën e konstatimit së procedura në fjalë ishte karakterizuar me shkelje ligjore esenciale, rrejdhimisht kërkesat formale të përgjithshëm të konkursit përkatës, kanë qenë të vendosur në kundërshtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, shkelje këto që në vlerësimin e Këshillit e kanë bërë në tërësi si të paligjshme procedurën e kontestuar.

-Kryetari i Komunës së Gjilanit në zbatim të Vendimit A.nr.2110/2024, të datës 20.02.2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.03.2025 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 02-016-18628/25, me të cilin ka bërë anulimin e konkursit me Nr. Referencës: RN0001530 për pozitën Zyrtar për gjendjen Civile 1, dhe Akt Emërimin e lëshuar për ankuesin Nr. 02/016-136672/24 të datës 31.12.2024.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill kundër Vendimit me numër protokolli 02-016-18628/25 të datës 07.03.2025, të Kryetarit të Komunës së Gjilanit, pretendon për kompensimin e mjeteve materiale prej datës 01.01.2025 deri në vendimin e Kryetarit të Komunës së Gjilanit.

Kolegji i Këshillit në trajtimin e kësaj çështja juridikë administrative thekson faktin e pa kontestuar së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në mandatin kushtetuese të përcaktuar me nenin 102 të Kushtetues së Kosovës është institucion i pavarur që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, mandat të cilin e ushtron përmes funksionit të monitorimit dhe shqyrtimit të ankesave, dhe së vendimet e Këshillit në kuptim të nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë vendime administrative të formës së prerë dhe zbatohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues. Gjegjësisht, në zbatim të këtij përcaktimi ligjor, Kryetari i Komunës së Gjilanit ka zbatuar Vendimin A.nr.2110/2024, të datës 20.02.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku si pasojë ankuesit i është anuluar edhe Akti i Emërimit i lëshur më datë 31.12.2024, lidhur me pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile.

Për me tepër, duke u bazuar në nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se : *Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj,*

*parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën.* Kolegji i Këshillit konstaton se në çdo rast të parashtrimit të ankesës si mjet i rregullt juridik në procedurë administrative, ankesa ka efekt pezullues dhe se akti i kontestuar ende nuk ka karakterin e aktit definitiv ( të ekzekutueshëm), pra, mbi këtë bazë të këtij konstatimit, rrjedhë se Komuna e Gjilanit ka qenë e njoftuar se lidhur me konkursin e cekur si më lartë është parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj e njëjta ka qenë e obliguar që të ndërmarr të gjitha veprimet për pezullimin e akti të emërimit për rastin e ankuesit, edhe pse sipas përgjigjes në ankesë të datës 28.04.2025, Komuna e Gjilanit ka njoftuar se nuk e kanë përcjell akt emërimit në Thesar për ekzekutim, mirëpo që pala ka vazhduar punën deri në nxjerrjen e vendimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Gjilanit. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, thekson se pezullimi nga Komuna e Gjilanit ka qenë obligim të behet edhe në raport me prezencën në punë të ankuesit, andaj duke qenë se sipas Vendimi me numër A.nr.2110/2024, të datës 20.02.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, procedura e pranimit për pozitën e cekur më lartë është anuluar, atëherë, ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil, e për rrjedhojë sipas nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli ka mandat të shqyroj vetëm ankesat e nëpuënsve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, në rastin konkret nuk është kompetente të shqyroj ankesën e ankuesit.

Kolegji i Këshillit udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

*Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.*

**Këshillë juridike:** *Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda me numër: A.nr.590/2025*

**Avdyl BEKTESHI**

*Procesmbajtës*

**Malsore Gashi BAJRAKTARI**

*Kryetare e Kolegjit*

### **Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit S.N.
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.